

STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TRADE TRANSPORT CO" SHPK

Ne daten 24.05.2012 qytetin e Korces duke u bazuar ne vullnetin e tyre te lire e te singerte dhe ne mirekuptim te plote, pershtatin statutin ne baze te ligjit 9901 date 14.04 2008 " Neni 230 pika 2 , Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare Ortaket:

- 1- Lorenc Bellovoda, biri i Kristaq , datlindja 27.5.1967 shtetas Shqiptar, banues ne Korce posedues i Kartes se Identitetit nr 028812779 mbajtes i Nr Kombetar te Identifikimit G70527096V madhor i afte per te kryer veprime juridike.

Kane hartuar kete STATUT te pershtatur me ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, lidhur me organizimin, administratimin dhe drejtimin e shoqerise tregetare "Trade Transport Co" SHPK, , me seli Zona Industriale Korce, Shqiperi.

Shoqeria eshte " Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar " ku ortaket mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te neneshkruara .
Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar .

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

Shoqeria Tregetare do te mbaje emrin "Trade Transport Co" SHPK i cili do te jete i stamosur dhe ne vulen e saj dhe te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat e nxjera nga shoqeria dhe qe u drejtohen te treteve .
Per marredheniet e saj me subjektet jashte territorit te Shqiperise , shoqeria do mbaje te njejtin emertim me germen Latine.

NENI 2
SELIA E SHOQERISE

TRADE TRANSPORT Co.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORCA - IRANAATLBANIA
☎ +3558242191.Fax 35582464
TRADETRANS@117200.YA@00.COM



Selia e Shoqerise eshte ne Qytetin e Korces, Autostrada Korce Bilisht Km.3 . Perballe karburantit Alpet Korce, Shqiperi. Shoqeria mund te krijojë dege e filjale ne rrethe te tjera te Shqiperise dhe jashte saj .

NENI 3

Shoqeria Tregetare "Trade Transport Co" SHPK eshte subjekt juridik Shqiptar dhe veprimtarine e saj e bazon ne legjislacionin Shqiptar dhe kryesisht ne ligji 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare "

Regjistrimi i saj ne regjistrin tregetar ndodhur ne QKR behet sipas dispozitave te ligjit 9723 date 03.05.2007 , Per Qendren Kombetare te Regjistrimit .

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e veprimtarise te Shoqerise do te jete mbi 10 vjet e cila ka filluar nga momenti i rregjistrimit te pare te shoqerise.

NENI 5

Personalitetin e saj ligjor shoqeria e fiton nepermjet vendimit te regjistrimit prane QKR.

NENI 6

Objekti i veprimtarise ekonomike dhe qellimi i shoqerise eshte :

1. Tregetim artikuj te ndryshem Inport-Eksport

NENI 7

Kapitali i shoqerise ka vleren 20.670.738 leke, Numri i Pjeseve 20.670,00 Vlera nominale e nje aksioni eshte 1.000,04 Leke
Ndarja e Aksioneve midis ortakeve te shoqerise do te jete

- 1- Ortaku Lorenc Bellovoda ne masen 100 % .

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje shume me te vogel ne shumen minimale e parashikuar nga ligji e detyron shoqerine te plotesoje ate , perndryshe ajo do te shnderohet ne nje forme tjeter ose te priset .

Kontributet e shërbimit nuk mund të shpërblehen me pjesë në kapitalin themeltar .

NENI 8

Ndalohet emetimi i letrave me vlerë nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Po që se bëhet një gjë e tillë ky emetim është i pavlefshëm . Shoqëria nuk mund të ofrojë kuotat e saj si mjete investimi për publikun e gjerë.

NENI 9

KUOTAT E KAPITALIT

Transferimet e kuotave të kapitalit duhet të kryhen me akt noterial . Ato mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet shit bërjes, dhurimit me rrugë trashëgimie ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj .

Neqoftese pjesët që transferohen përbejnë pasuri të përbashkët , bashkeshorti i transferuesit duhet të japë pelqimin e tij .

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri . Në këtë rast transferimi duhet të jetë i miratuar nga ortakët në kushtet e shumicës së kërkuar për ndryshimet në statut .

Perfituesit që përfitojnë nga transferimi detyrohen të disponojnë kapitalin e përfituar për nevojat e shoqërisë , duke marrë parasysh të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kishte mbajtësi i kapitalit . Transferimet nëpërmjet ortakëve kryhen lirisht , Ndryshimet të pjesëve të kapitalit themeltar duhen të pasqyrohen në statut dhe në QKR .

NENI 10

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit vendoset në shumicën e parashikuar në ndryshimet e statutit .

Zmadhimi i kapitalit për kontributet në para bëhet duke depozituar për llogari të shoqërisë në një bankë fondet në para ose nëpërmjet bërjes të makinerive të ndryshme .

TRADE TRANSPORT CO.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORÇA - IRANA ATLBANIA
☎ +3558242191 . Fax 35582464
TRADETRANSPORT@YAHOO.COM



...et e reja te kapitalit themeltar mund te neneshkrunen qofte nga
...ake egzistues , qofte nga persona jo ortake .
Zmadhimi i kapitalit mund te behet nepermjet perfshirjes ne te te
rezervave te lira te fitimeve te pashperndara .
Zmadhimi i kapitalit plotesisht ose pjeserisht me ane te kontributeve ne
natyre behet ne baze te nje raporti te ekspertit kontabel emeruar sipas
legjislacionit Shqiptar .

NENI 11

ZVOGELIMI I KAPITALIT

Ne rastin e marjes te vendimeve , qe kerkojne nje shumice te zakonshme,
asambleja e pergjithshme , mund te mare vendime te vlefshme vetem
nese marin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se
30% te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te
vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar , sipas
nenit 87 te ketij ligji , ajo mund te mare vendme te vlefshme vetem nese
ortaket zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te
pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas
parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te
mungeses se kuorumit te permendur ne piken 1 te ketij neni , asambleja
mblidhet perseri jo me pak se 30 dite , me te njejtin rend dite .

Me perjashtim te rasteve kur statuti parashikon nje shumice me te
larte , asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te
ortakeve pjesmares , sic percaktohet ne piken 1 te nenit 86 te ketij ligji ,
per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te
regjistruar, shperndarjen e fitimeve, rirganizimin dhe prishjen e
shoqerise . Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete
ligj ose ne statut, per ceshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ketij
ligji, asambleja e pergjithshme vendos me shumice votave te ortakeve
pjesmares .

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete ligj,
vlefshmeria e vendimeve , qe percaktojne detyrimet shtese mbi ortaket ,
apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre , te parashikuara ne kete ligj
apo statut , kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates .

NENI 12

ASAMBLEA E PERGJITHESHME

Organi vendimares i shoqerise eshte asamblea e pergjitheshme.
Asamblea e pergjitheshme thiret nga administratori Thirja e asamblese
behet me shkrese e cila duhet te permbaje vendin , daten , oren e
mbledhjes dhe rendin e dites dhe dergohet me leter rekomande te pakten
7 dite perpara mbledhjes se asamblese .

Cdo mbledhje e thirrur ne menyre te paregullt mund te anulohet.

Administratori duhet t'u komunikojne ortakeve :

Inventaret , llogarite vjetore (Bilancin), vendimet e propozuara, raportin e
administrimit , raportin e ekspertit kontabel ne qofte se ka nje te
tille. Asambleja miraton llogarite , nese eshte e nevojeshme pas raportit te
eksperteve kontabil te autorizuar , brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit
financiar.

Ortakët kanë të drejtë t'i drejtojnë pyetje me shkrim administrtorit , i cili duhet t'u përgjigjet në mbledhjen e asamblese .
Ekspereti i autorizuar , kur ai ekziston ka të drejtë të marrë pjesë në çdo asamble .

Eksperet kontabel i autorizuar , kur ai ekziston ka të drejtë të marrë pjesë në çdo asamble

Asambleja e përgjithëshme ka të drejtë të emerojë dhe të shkarkojë ekspertet kontabel , likuiduesin dhe administrtorët e shoqërisë .

Asambleja e përgjithëshme ka të drejtë të caktojë , politikat tregëtare të shoqërisë , pjestimin e kuotave , miratimin e pasqyrave financiare, transferimin ose pjestimin e kuotave , riorganizimin e shoqërisë , apo çdo lloj cështje tjetër të parashikuar në statut apo në ligjin " Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare " .

Asambleja e përgjithëshme të shprehet për zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit , ndryshimin e objektit dhe për prishjen e shoqërisë si dhe për çdo ndryshim tjetër në statut .

Asambleja e përgjithëshme vendosën për ndryshimet në statut , shitjen e pasurisë të palujtëshme , makineri pajisje , krijimin e filjaleve të reja , bashkimin e shoqërisë .

Në asamble ortakët mund të përfaqësohen nga një person tjetër jo ortak sipas mandatit përkatës .

Asambleja e përgjithëshme drejtohet nga administrtorët e shoqërisë .

Çdo vendim ose të ortakëve duhet të evidentohet me një proces verbal i cili hartohet në një regjistër të posaçëm që mbahet në selinë e shoqërisë .

Vendimet në asamble e përgjithëshme vendosën nga ortakët që përfaqësojnë me shumë se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar .

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme asambleja e përgjithëshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë me shumë se 30% . Në rastin kur asambleja e përgjithëshme duhet të vendosë cështje që kërkojnë shumicë vote të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit nr. 9901 mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët që zoterojnë me shumë gjysmën e numurit total të votave .

NENI 13 ADMINISTRIMI

Administrtori është përfaqësues ligjorë i shoqërisë ndaj të tjerëve .

Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhënie me të tjerët në emër të shoqërisë, në të gjitha rethanat .



TRADE TRANSPORT Co.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORÇA - IRANA ATLBANIA
+3558242191. Fax: 35582464
TRADETRANS@33T2030@YAHOO.COM

Shoqeria Tregtare "Trade Transport Co" " SHPK do te administrohet nga z. Lorenc Bellovoda, i cili do te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha veprimtarine e saj.

Administratori emerohet per nje perudhe 5 (pese) vjecare me te drejte riparteritje.

Administratori mund te shkarkohet nga asambleja me shumice te zakoneshme .

Administratori kryen te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise .

Administratori ka keto kompetenca :

- Kryejne te gjitha veprimet ne interes te shoqerise , pervec atyre qe shprehimisht kane ortaket .
- Komunikojne asamblese se ortakeve , inventaret , llogarite vjetore , raportin e administrimit , raportin e ekspertit kontabel.
- Pergatiten raportin vjetor per veprimtarine e shoqerise dhe ja paraqet ate asamblese se ortakeve .
- Siguron zbatimin e vendimeve qe jep asambleja e ortakeve .
- Siguron zbatimin e vendimeve qe jep asambleja e ortakeve .
- Propozon krijimin e organeve te reja per permiresimin e punes .
- Perfaqeson shoqerine tregtare ne organet administrative , gjyqesore doganore , fiskale , dhe zgjidhen mosmarveshjet me te tretet .
- Neneshkruajne per llogari te shoqerise kontrata.
- Lidhen kontratat individuale dhe ato kolektive te punes.
- Mbajne librat kontabel.
- Neneshkruan bilancin vjetor.
- Kryejne cdo detyre tjeter te percaktuar ne ligjin " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare "dhe ne statut.

Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratoreve edhe kur ato nuk perfshiheshin ne objektin e shoqerise. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe aktet e administratoreve e kalonin objektin e shoqerise . Administratori nuk mund te behet dorezanes apo te garantoje ne emer te tij angazhimet ndaj te tretteve .

Administratoret mund te shkarkohet me vendim te asamblese se ortakeve. Administratori mund te delegoje kompetenca te vecanta por nuk mundte delegoje teresine e kompetencave te tyre .



TRADE TRANSPORT CO.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORCA - IRANAATLBANIA
+3558242191 . Fax: 35582464
TRADETRANS@TT2020.YAHOO.COM

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tregëve për shkëlqje ligjore, për shkëlqjen e këtij statuti, për fajet të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori ka detyrimin e besnikërisë ndaj shoqërisë.

NENI 14 EKSPERTI KONTABEL

Asambleja e ortakëve cakton ekspert kontabel për një periudhë prej 2 vitesh financiare.

Emërtimi i ekspertit bëhet nga asambleja e përgjithshme. Gjithashtu ai emëron dhe një zëvendës ekspert kontabel në rast të mos pranimit, pengimit dorëheqje ose vdekje të ekspertit kontabel.

Eksperti kontabel zgjidhet nga një listë e hartuar nga organizimi profesional i eksperteve kontabel.

Nuk mund të jenë ekspertet kontabel administratorët e shoqërisë si dhe paraardhësit, bashkëshortet e tyre, themeluesit si dhe personat e afertë deri në shkallën e katërt.

Eksperti kontabel mund të japë dorëheqjen për arsye personale.

Eksperti kontabel ka për detyrë të:

- Kontrollon vlerat dhe dokumentet kontabel të shoqërisë.
- Të kontrollojë pajtueshmërinë e kontabilitetit të shoqërisë me legjislacionin në fuqi.
- Të verifikojë përputhjen me llogaritë vjetore.

Eksperti kontabel nuk duhet të përzihet në drejtimin apo administrimin e shoqërisë.

Eksperti kontabel duhet të informojë administratorin për:

- Kontrollin dhe verifikimin që janë kryer.
- Vërejtjet për ndryshime që sipas tyre u duhen bërë bilancit dhe dokumentit kontabel.
- Përgjithësitë dhe pasqyret që janë zbuluar.

Eksperti kontabel duhet të informojë asambletë e ortakëve për:

- Një raport të përgjithshëm për verifikimin dhe kontrollin e kërkuar nga ligji.
- Vërejtjet për llogaritë vjetore.
- Raportin për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar.

Eksperti kontabel mban përgjegjësi për shqyrtimin e llogarive dhe rregullshmerinë e tyre.

TRADE TRANSPORT Co.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORÇA - IRANA ATLBANIA
☎ +3558242191 Fax 35582464
TRADETRANS@11T2910@YAHOO.COM

Eksperti kontabel eshte pergjegjesi si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj paleve te treta per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvleresimet e tyre gjate ushtrimit te funksioneve perkatese .

NENI 15 VITI FINANCIAR

Rezultatet e veprimtarise te cdo shoqerie tregetare vleresohen periodikisht ne fund te cdo viti financiar.

Kohezgjatja e vitit financiar eshte 12 muaj dhe perputhet me vitin kalendaristik .

Per te pasur llogari vjetore qe te pasqyrojne realisht pasurine dhe gjendjen financiare, shoqeria duhet te ;

Mbaje nje kontabilitet te rregullit ne perputhje me kerkesat e ligji

Te kontrolloje me inventar ekzistencen dhe vleren e pasurise ne mbyllje te vitit financiar.

NENI 16 FITIMI

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar , te cilit i jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mepareshme .

NENI 17 DIVIDENTET

Asambleja e pergjitheshme mund te vendose shperndarjen e dividendeve vetem pasi :

- Te kete miratuar llogarite vjetore .-Te kete percaktuar shumen qe do te ndahet .

Cdo dividend i shperndare duke shkelur rregulla, perben nje dividend fiktiv.

NENI 18 SHNDERRIMI , BASHKIMI DHE LIKUJDIMI

Shoqeria mund te ndryshoje formen e vet ligjore , nepermjet shndrimit , si me poshte ;

- a) Mund te shndrohet ne shoqeri aksonere dhe anasjetas
- b) Shoqeria aksionere e me oferte private mund te shndrohet ne nje shoqeri aksonere me oferte publike dhe anasjetas , nese

TRADE TRANSPORT Co.
CARPETS - FLOOR COVERINGS
KORÇA - IRANAATLBANIA
+3558242191 Fax 35582464
TRADETRANSP@13722970@YAHOO.COM

- permbushen kerkesat e ketij ligji te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te regjistrimit " dhe te ligjit per titujt " .
- c) Shndrrimi i shoqerise nga SHPK ne Shoqeri Anonime behet me vendim, sipas kushteve te percaktuara ne ligj.
 - d) Shoqeria mund te bashkohet me shoqeri te tjera me vendim te Asamblese e Pergjitheshme .
 - e) Shoqeria eshte ne likujdim e siper nga momenti i prishjes se saj per cdo lloj shkaku pervec rastit kur kemi te bejme me bashkimin e pjeseve te kapitalit .
 - f) Kur vendoset prishja e shoqerise , asamblea e pergjitheshme cakton likujdatorin , akt i cili regjistrohet ne regjistrin tregetar prane QKR.
 - g) Aktet e likujdimit se bashku me llogarite perfundimtare depozitohen ne regjisterin tregtar prane QKR.
 - h) Mbas mbylljes se likujdimit dhe depozitimit te dokumentave ne regjistrin tregtar , shoqeria c' regjistrohet prej tij .
 - i) Likujdatori eshte pergjegjes si ndaj shoqerise ashtu edhe ndaj paleve te treta per pasojat e demshme qe rrjedhin nga fajet dhe nenvlefesimet e tyre gjate ushtrimit te funksioneve perkatese .

NENI 19

Ky statut i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar u hartua ne 4 kopje , ne gjuhen Shqip dhe neneshkruhet me deshiren e ortakeve te vetem duke vendosur emrin , mbiemrin dhe firmen origjinale ne te gjitha kopjet e tij.

ORTAKU THEMELUES
LORENC BELLOVODA


TRANSPORT Co.
TRADE FLOOR COVERINGS
CARPETS - IRANAATLBANIA
KORCA
+3558242191 Fax 35582464
TRADETR. 452 111 29 0 YAQQ.COM